



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 38, datë 31.03.2020**

**PËR**  
**MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**“EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të shoqërisë “Eurosig” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2019, sipas përllogaritjes të shoqërisë.**
- 2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2019 të provigjoneve teknike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:**

| <b>Provigjonet teknike në 31 dhjetor 2019</b>                                 | <b>Lekë</b>          |
|-------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| <b>Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total</b>                  | <b>2,536,194,665</b> |
| <i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i> | <i>570,944,423</i>   |
| <b>Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total</b>                   | <b>1,965,250,242</b> |

- 3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Ervin METE \_\_\_\_\_ KRYETAR**

**Idlir GJATA \_\_\_\_\_ ANËTAR**

**Deniz DERALLA \_\_\_\_\_ ANËTAR**